V E N D I M
Nr. 373, datë 14.7.2000

PËR RIVENDOSJEN E SISTEMIT TË KUJDESTARËVE DHE TË ROJEVE, NË OBJEKTET MONUMENT KULTURE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8279, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", të nenit 7, të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000" dhe të neneve 2 dhe 116, të ligjit nr.7867, datë 12.10.1994, "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Rivendosjen e sistemit të kujdestarëve dhe të rojeve, në objekt monument kulture.
2. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e vitit 2000, t'i shtohet fondi prej 3 270 000 (tre milionë e dyqindeshtatëdhjetë mijë) lekësh, në zërin "shpenzime operative".
3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
4. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që:
a) të hartojë listën e monumenteve të kulturës, që do të vendosen nën kujdestari, apo në ruajtje;
b) të bëjë shpërndarjen e fondit, të miratuar sipas listës së mësipërme;
c) të nxjerrë aktet në zbatim të këtij vendimi.
5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta